



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1072

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) NIKA PrO- Ing SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndertimi i tribunes lindore te stadiumi 2 Korriku - faza e III-te me numër të prokurimit 616-25-7285-5-2-1, me 13.01.2026, mori

Vendim

I. Aprovohet, si pjesërsihtë e bazuar ankesa e OE NIKA PrO- Ing SH.P.K. me nr. 2025/1072 , e datës 31.10.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndertimi i tribunes lindore te stadiumi 2 Korriku - faza e III-te me numër të prokurimit 616-25-7285-5-2-1.

II. Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Ndertimi i tribunes lindore te stadiumi 2 Korriku - faza e III-te me numër të prokurimit 616-25-7285-5-2-1 kthehet në Rishqyrtim.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.616-25-7285-5-2-

IV. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërsihte e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 08.08.2025 Kuvendi i Komunës së Prishtinës., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Ndertimi i tribunës lindore të stadiumi 2 Korriku - faza e III-te me numër të prokurimit 616-25-7285-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 167,138.19 €

Me 15.10.2025 Kuvendi i Komunës së Prishtinës., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë Hart Engineering SHPK.

Me 20.10.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 20.10.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 31.10.2025, OE NIKA PrO- Ing SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1072, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues NIKA PrO- Ing SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

AK/Komisioni vlerësues, gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë, nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Rregulloren e Udhëzimit Operativ për Prokurim Publik. AK/Zyra e Prokurimit, me datë 15.10.2025, ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e AK, duke rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm.

Në përputhje me nenin 7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, kemi dorëzuar kërkesë për qasje në dokumentacionin përkatës, ku AK ka ofruar qasjen. Gjatë analizimit të dokumentacionit të ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, kemi vërejtur se është totalisht i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit.

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, me datë 20.10.2025 kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim, ndërsa refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me datë 22.10.2025, duke mos dhënë asnjë arsyetim konkret se përse pretendimet tona ankimore janë të pabazuara. Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues nuk është i bazuar dhe nuk e pasqyron gjendjen reale dhe faktike të procedurës së prokurimit.

Në vijim të kësaj ankese, do të paraqesim në mënyrë të qartë, të detajuar dhe të argumentuar për secilin nga pretendimet tona ankimore. Këto pretendime do të mbështeten në prova konkrete dhe dokumentacion përkatës, përmes të cilave vërehet qartë se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe me obligimet që burojnë nga dokumentet e tenderit.

Pretendimi 1 – GOE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm dhe duhet eliminuar automatikisht, ngase DEKLARATA PËR THEMELIMIN E GRUPIT nuk është sipas formularit standard të miratuar nga KRPP.

Argumenti ynë: DEKLARATA PËR THEMELIMIN E GRUPIT nga GOE i rekomanduar nuk është sipas formularit standard të miratuar nga KRPP me datë 11.11.2024. Marrëveshja e themelimit të grupit të operatorëve ekonomik nuk është konform formularit standard të miratuar nga KRPP, ku duhet të ndahet përqindja, përgjegjësit etj.

SHIH DEKLARATËN PËR THEMELIM TË GRUPIT TË MIRATUAR NGA KRPP KONFORM LPP-së

Anëtarët e grupit lidhin këtë marrëveshje me të cilën deklarojnë:

Ne, të gjithë anëtarët e grupit, jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i jepet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.

Ne, të gjithë anëtarët e grupit, konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe se nuk jemi duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtë të prokurimit.

Ne, të gjithë anëtarët e grupit, e autorizojmë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe ai është: [Shëno emrin e liderit të grupit].

Ne, të gjithë anëtarët e grupit, konfirmojmë se jemi të përshtatshëm dhe do të sigurojmë dëshminë mbi përshtatshmërinë, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të FDT-së.

Ne, të gjithë anëtarët e grupit, konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se përqindja e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës është:

a) [Shëno % e pjesëmarrjes së Liderit]

b) [Shëno % e pjesëmarrjes së anëtarit]

(Shto sipas nevojës)

Ne, të gjithë anëtarët e grupit, konfirmojmë përgjegjësitë e secilit anëtar:

a) [Shëno përgjegjësitë e Liderit]

b) [Shëno përgjegjësitë e anëtarit]

GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar fare deklaratë, por një marrëveshje bashkëpunimi shabllon, ku madje nuk kanë caktuar as liderin e grupit, nuk kanë konfirmuar as ndarjen e realizimeve të kontratës në përqindje %, nuk kanë konfirmuar as përgjegjësit e liderit, nuk kanë konfirmuar as përgjegjësit e anëtarit etj., dmth., në kundërshtim me LPP-në.

GOE i rekomanduar nuk ka dorëzuar deklaratën për themelimin e grupit sipas formularit standard të miratuar nga KRPP me datë 11.11.2024.

Nga data 11.11.2024, kur hynë në fuqi Rregullorja nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të gjithë OE që ofertojnë në aktivitete të prokurimit pas kësaj date duhet të përdorin “Deklaratën për Themelimin e Grupit” sipas formularit standard të miratuar nga KRPP me datë 11.11.2024.

Mungesa e përmbushjes së formularit të përcaktuar për konsorciumin, ku Operatori Ekonomik nuk ka respektuar formën dhe strukturën e konsorciumit të përcaktuar nga KRPP, ku specifikohet qartë forma e marrëveshjes dhe ndarja e përgjegjësi si dhe ndarja e realizimit të kontratës.

Ky element është kërkesë e detyrueshme dhe mosplotësimi i saj përbën arsye automatike për eliminim sipas kritereve të qarta të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

SIPAS UDHËZUESIT Nr. 002/2024 PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

– Mungon deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës.

– Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtijshëm.

– Kusht administrativ.

Konkretisht, kërkohet deklarata e qartë; në rastin konkret nuk kemi të qartë asgjë dhe mbi të gjitha nuk është ofruar as deklarata nga GOE i rekomanduar, por vetëm një marrëveshje që totalisht është në kundërshtim me LPP-në.

Për më tepër, ekziston vendimi i qartë i OSHP-së nr. 2025/0532 i datës 28.08.2025, i cili thekson se mosplotësimi i Deklaratës për Themelimin e Grupit sipas formularit standard të miratuar nga KRPP përbën arsye automatike për eliminim.

Ekziston një fakt thelbësor dhe i pamohueshëm që grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratën për themelimin e grupit sipas formularit standard të miratuar nga KRPP. Zyrtari përgjegjës i prokurimit, në vendimin e tij, i është shmangur trajtimit të pretendimit tonë thelbësor, pra nuk ka mohuar dhe as provuar që deklarata për themelimin e grupit e operatorit të rekomanduar është sipas formularit standard të miratuar nga KRPP.

Në këtë rast, edhe nëse Komisioni i Vlerësimit ka bërë një gabim, zyrtari përgjegjës i prokurimit është person kompetent që miraton ose refuzon rekomandimin, prandaj mban përgjegjësi të plotë për miratimin e një rekomandimi të paligjshëm. Pra, mungesa e Deklaratës për Themelimin e Grupit sipas formularit standard të miratuar nga KRPP është fakt objektiv që as Komisioni, as ZPP nuk mund ta anashkalojnë pa cenuar ligjin.

Në këto kushte, operatori i rekomanduar ka dorëzuar ofertë të paplotë dhe të pakualifikueshme, ndërsa Autoriteti Kontraktues Komuna Prishtinës, në kundërshtim të plotë me ligjin, ka bërë vlerësim të padrejtë dhe ka rekomanduar për kontratë një ofertë që s’duhej as të kalonte fazën e verifikimit administrativ.

Ky veprim është shkelje flagrante e parimeve të barazisë, transparencës dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë, të përcaktuara me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe bie ndesh me nenin 6 të të njëjtit ligj, që kërkon respektim të integritetit të procesit dhe vlerësim vetëm në bazë të kriterëve të dokumentuara. Ky është shembull tipik i favorizimit të paarsyeshëm dhe vlerësimit selektiv, që kompromenton të gjithë procesin e prokurimit publik dhe krijon precedent të rrezikshëm për ligjshmërinë e procedurave të ardhshme.

GOE i rekomanduar duhet të eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit. Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me vendimet e OSHP-së.

Pretendimi 2 – GOE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm lidhur me kontratat e stafit.

Argumenti ynë:

GOE i rekomanduar nuk ka arritur të plotësojë kërkesën 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional; është në kundërshtim me LPP-në, pasi ka ofruar dokumente shtesë pas skadimit të afatit për dorëzim të tenderëve.

Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet, ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Kërkojmë që edhe ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën e OSHP-së.

Pretendimi 3 - GOE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm lidhur me autorizimet

Kërkesat e AK:

6. Autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar) për pozicionet 2.2, 4.1, 5.1, 5.2, 5.4, 6.1, 7.2, 9.4.

Argumenti ynë:

GOE i rekomanduar ka ofruar autorizime ku nuk ceket as titulli i aktivitetit, as numri i prokurimit, por mbi të gjitha nuk ceket se për cilat artikuj janë ato autorizime.

GOE i rekomanduar është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje Tenderit. Këto autorizime janë fiktive dhe jo legjitime. GOE i rekomanduar duhet të eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit.

Gjithashtu kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën e OSHP-së.

Pretendimi 4 - GOE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm lidhur me certifikatat CE dhe ENEC

8. Operatori ekonomik duhet të ofrojë certifikata CE dhe ENEC për trupat ndriçues.

Argumenti ynë:

GOE i rekomanduar ka ofruar certifikata të nxjerra nga Google dhe jo sipas kërkesës së AK. Kjo kërkesë nuk është përmbushur konform kritereve të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe DT, pasi kanë ofruar vetëm certifikata të nxjerra nga interneti.

Kërkojmë që edhe këto pretendime të merren seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së.

Si përfundim GOE i rekomanduar për kontratë është totalisht i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit.

Duke u bazuar në argumentet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pabazuar dhe njëkohësisht është arsyetim blanko, duke mos dhënë asnjë arsyetim se përse pretendimet tona ankimore janë të pabazuara. Andaj ky veprim i AK-së e tregon qartë faktin se pretendimet tona ankimore janë të BAZUARA.

Duke pasur parasysh të gjitha këto dëshmi, vijmë në përfundim se GOE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet automatikisht nga konkurrenca, e jo të favorizohet duke u shpallur fitues i këtij tenderi.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si Operator Ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të lirë dhe duke rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do t’i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.”

Po ashtu, paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguara të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike, si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar, si dhe nuk ekzistojnë

pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

I DEKLARATA PËR THEMELIMIN E ARGOPE nga GOE i rekomanduar nuk është në përputhje me OSHP sipas Formularit Standard të miratuar nga KRPP me datë 11.11.2024.

Marrëveshja e themelimit të grupit të operatorëve ekonomik nuk është konform formularit standard të miratuar nga KRPP, ku duhet të ndahet përcaktimi i përgjegjësisë etj.

GOE i rekomanduar ka ofruar autorizime ku nuk cekët as titulli i aktivitetit as numri i prokurimit, por mbi të gjitha nuk cekët se për cilat artikuj janë ato autorizime.

Është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje Tenderit.

Këto autorizime janë fiktive dhe jo legjitime.

8 - Operatori ekonomik duhet të ofrojë certifikata CE dhe ENEC për trupa ndriçues.

Argumenti ynë:

GOE i rekomanduar ka ofruar certifikata të nxjerra nga Google dhe jo sipas kërkesës së AK. Kjo kërkesë nuk është përmbushur konform kriterëve të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe DT, pasi kanë ofruar vetëm certifikata të nxjerra nga interneti.

Parashtruesi po ashtu ka parashtruar pretendime ankimore sipas të cilave oferta e tenderuesit të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme për arsyet e prezantuara në kërkesën për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur se tenderuesi i rekomanduar, mbi bazën e vlerësimit dhe të gjeturave të komisionit vlerësues, është konstatuar se marrëveshja për themelimin e GOE është hartuar në mënyrë të rregullt. Po ashtu tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar me rregull sipas DT edhe licencat dhe certifikatat për të cilat bëhet fjalë në pretendimet ankimore.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1 nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1 nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 04.11.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1072, ndërsa me datë 15.11.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1072, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet Vendimi i AK për kualifikimin e Operatorëve Ekonomik dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE NIKA PrO- Ing SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1072 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimet Ankimore:

Përgjigje në Pretendimin 1.

Operatori ekonomik ankues pretendon se konsorciumi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Deklaratën për Formimin e Grupit të Operatorëve Ekonomik në kundërshtim me formularin standard të miratuar nga KRPP. Dokumenti i paraqitur nga grupi fitues përmban mangësi përmbajtësore, pasi nuk specifikon ndarjen e punëve dhe përgjegjësi ndërmjet anëtarëve, përqindjen e realizimit të punimeve për secilin prej tyre dhe nuk përcakton qartë liderin e grupit dhe përgjegjësitë e tij. Sipas Udhëzimit Administrativ të KRPP nr. 002/2024, mungesa e një deklarate të qartë që konfirmon përgjegjësinë e përbashkët dhe individuale të të gjithë anëtarëve të grupit paraqet kusht administrativ dhe rezulton në refuzim të tenderit pa kërkuar informacion shtesë. Kjo bie gjithashtu ndesh me kërkesat e LPP-së. Ankuesi i referohet edhe vendimit të OSHP-së nr. 2025/0532, i cili përcakton se mosplotësimi i deklaratës sipas formularit standard të KRPP-së përbën arsye automatike për eliminim. Për këto arsye, ankuesi konsideron se grupi fitues është dashur të eliminohet si operator ekonomik i papërgjegjshëm nga autoriteti kontraktues.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues ka konstatuar se grupi i operatorëve “Hart Engineering SHPK” dhe “Art Dekor DPT” ka dorëzuar një marrëveshje bashkëpunimi për formimin e grupit të operatorëve ekonomikë në aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i tribunës lindore të stadiumit ‘2 Korriku’ – Faza III”. Nga analiza e kësaj marrëveshjeje rezulton se dokumenti nuk përmban elementet e detyrueshme të përcaktuara në formularin standard të KRPP-së për formimin e grupit të operatorëve ekonomikë. Më konkretisht nuk është bërë ndarja e punëve dhe përgjegjësi ndërmjet anëtarëve të grupit, as përqindja e realizimit të punimeve nga secili anëtar, nuk është përcaktuar qartë lideri i grupit por vetëm është autorizuar z. Atakan Kuqani, në cilësinë e drejtorit të “Hart Engineering SHPK”, për të përfaqësuar konsorciumin dhe për të nënshkruar dokumentacionin dhe pesë elementet e tjera të detyrueshme të parashikuara në formularin standard të KRPP-së për themelimin e grupit nuk figurojnë në marrëveshjen e dorëzuar.

Formulari standard i KRPP-së, i përfshirë në dosjen e tenderit, përcakton të gjitha informacionet dhe kushtet që duhet t'i përmbajë marrëveshja e formimit të grupit, siç parashihet edhe në nenin 44 të Rregullores nr. 001/2022 të KRPP-së. Mospërdorimi i këtij formulari dhe mospërfshirja e informacionit të detyrueshëm përbën shkelje të kërkesave të qarta ligjore dhe procedurale, në kundërshtim me nenin 26 të Rregullores nr. 001/2022 si dhe nenin 71 të LPP-së.

Për shkak të këtyre mangësive përmbajtësore të marrëveshjes për formimin e grupit, oferta e konzorciumit të operatorëve ekonomikë të rekomanduar duhet të konsiderohet e papërgjegjshme në aspektin administrativ. Në këtë drejtim, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Pergjigje ne Pretendimin 2.

Në pretendimin e dytë OE ankues thekson se grupi i OE fitues nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për kapacitetin teknik dhe profesional sepse ka ofruar dokumente shtesë pas skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe është në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së.

Pas analizimit të pretendimit ankimor, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankues nuk është i argumentuar në mënyrë të plotë. Ankuesi nuk ka specifikuar se cilat dokumente shtesë të dorëzuara nga operatori ekonomik fitues pretendohet se janë pranuar në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së. Mungesa e identifikimit të qartë të dokumenteve përkatëse e bën pretendimin të paplotë dhe të pambështetur në prova.

Eksperti sqaron se, në përputhje me nenin 72 të LPP-së, autoriteti kontraktues ka të drejtë të kërkojë sqarime, plotësime ose dokumente shtesë nga operatorët ekonomikë, me kusht që dokumentet e kërkuara të dëshmojnë informata të cilat kanë ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave. Këto plotësime lejohen vetëm për të qartësuar ose konfirmuar dokumentacionin dhe nuk përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore për sa kohë nuk sjellin ndryshim të ofertës ose përmirësim të pozicionit konkurrues të operatorit.

Në rastin konkret, OE ankues nuk ka prezantuar argumente apo prova që dokumentet shtesë të dorëzuara nga grupi fitues nuk kanë ekzistuar para afatit të dorëzimit të ofertave apo që plotësimi ka tejkaluar kufijtë ligjorë të nenit 72 të LPP-së. Për këtë arsye, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i dytë i OE ankues është i papabazuar.

Pergjigje ne Pretendimin 3.

Operatori ekonomik ankues pretendon se grupi i operatorëve ekonomikë të rekomanduar për kontratë ka dorëzuar autorizime të paqarta, të cilat nuk përmbajnë titullin e aktivitetit të prokurimit dhe nuk specifikojnë artikujt përkatës. Ankuesi thekson se kërkesa e dosjes së tenderit kërkonte autorizime specifike për pozicionet 2.2, 4.1, 5.1, 5.2, 5.4, 6.1, 7.2 dhe 9.4, të cilat nuk janë të qarta dhe nuk rezultojnë të jenë mbuluar nga dokumentet e paraqitura nga grupi fitues.

Gjatë shqyrtimit të autorizimeve të dorëzuara nga grupi i operatorëve ekonomikë të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues ka konstatuar se dokumentet e paraqitura nuk përmbajnë elementet bazike të kërkuara në dosjen e tenderit. Më konkretisht, autorizimet nuk e specifikojnë aktivitetin e prokurimit për të cilin janë lëshuar, nuk përmbajnë referencë të qartë lidhur me pozicionet konkrete të kërkuara (2.2, 4.1, 5.1, 5.2, 5.4, 6.1, 7.2 dhe 9.4) dhe si të tilla nuk përmbajnë informacion të mjaftueshëm që të mund të vërtetohet lidhja e tyre me artikujt specifikë të paraparë në kërkesat teknike të dosjes së tenderit.

Mungesa e këtyre të dhënave esenciale e bën autorizimin të paplotë dhe të papërshtatshëm në raport me kërkesat e parashikuara nga autoriteti kontraktues. Këto mangësi përbëjnë devijim substancial nga dokumentacioni i tenderit dhe pamundësojnë verifikimin e kapacitetit teknik të ofertuesit fitues. Për këto arsye, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Pergjigje ne Pretendimin 4.

Operatori ekonomik ankues pretendon se, në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit, grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar certifikatat e kërkuara CE dhe ENEC për trupat ndriçues. Sipas ankuesit, dokumentet e paraqitura nga operatori fitues nuk janë certifikata të vlefshme të lëshuara nga organet kompetente të certifikimit, por materiale të shkarkuara nga interneti (Google), të cilat nuk përmbushin kriteret teknike dhe të pajtueshmërisë së përcaktuara nga autoriteti kontraktues. Për rrjedhojë, ankuesi vlerëson se operatori fitues nuk ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, dhe si i tillë duhet konsideruar ofertues i papërgjegjshëm.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues ka konstatuar se certifikatat e dorëzuara për trupat ndriçues përmbajnë mbishkrimet CE dhe ENEC, ashtu siç kërkohej nga dosja e tenderit. Në dokumentet e tenderit është përcaktuar qartë se si dëshmi për këtë kriter duhet të ofrohen “kopje të certifikatave CE dhe ENEC për trupat ndriçues”, pa u specifikuar ndonjë kërkesë shtesë lidhur me formën, lëshuesin, origjinalitetin apo verifikimin e tyre nga prodhues të caktuar apo organe të autorizuar.

Nga përmbajtja e dosjes së tenderit nuk rezulton të ketë kërkesa të detajuara që kufizojnë pranueshmërinë e certifikatave vetëm në dokumente të lëshuara nga prodhues apo institucione specifike të certifikimit dhe as nuk ka kërkesa për ndonjë detaj teknik apo vërtetim shtesë. Në këto rrethana, dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik fitues, sipas formës si është formuluar kërkesa në dosjen e tenderit, përmbushin kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktues. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të plotë të procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, konstaton se autoriteti kontraktues ka bërë devijime nga kërkesat e nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Konkretisht, është rekomanduar për kontratë një ofertë e cila, në aspektin administrativ, rezulton e papërgjegjshme, pasi grupi i operatorëve ekonomikë të propozuar nuk ka ofruar dokumentacionin e kërkuar nga dosja e tenderit në pajtim me kriteret dhe formularët standardë të KRPP-së.

Mospërputhjet e konstatuara në dokumentacion përbëjnë shkelje të kërkesave të detyrueshme të tenderit dhe, si rrjedhojë, duhej të çonin në eliminimin e ofertës së rekomanduar për kontratë. Në bazë të nenit 114 të LPP-së, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa e operatorit ekonomik ankues është pjesërisht e bazuar.

Në këtë drejtim, eksperti shqyrtues rekomandon që autoriteti kontraktues të kthejë aktivitetin e prokurimit në fazën e rivlerësimit, duke siguruar që procedura të harmonizohet me dispozitat e LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndertimi i tribunes lindore te stadiumi 2 Korriku - faza e III-te me numër të prokurimit 616-25-7285-5-2-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovet si pjeserishte e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues e mbështet pjeserishë raportin e ekspertit shqyrtues, duke ju referuar konstatimeve ne raportë, kështu duke aprovuar ankesen e OE si pjeserishtë të bazuara .

Lidhur me pretendimin ankimor 01 lidhur me marrëveshjen e konzerciumit Paneli Shqyrtues duke ju referuar Rregullores për prokurim publik neni 26, paragrafi 26.15. Kurdo që Operatorët Ekonomik marrin pjesë si grup, grupi i operatorëve ekonomik së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në emër të grupit. Autoritetet Kontraktuese duhet të vendosin këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, si dhe formën standarde të marrëveshjes të hartuar dhe miratuar nga KRPP. Paneli Shqyrtues vërehen se në Dosjen e tenderit për këtë aktivitet të prokurimit AK nuk ka vendosur ndonjë kërkesë e as edhe marrëveshjen e hartuar dhe te miratuar nga KRPP-ja e që i bije qe AK hartimin e DT-së e ka bërë në kundërshtim me nenin e larte cituar.

Marveshja e ofruar të konzerciumit GOE i rekomanduar ka ofruar deklaratë mbi marveshjen e konzerciumit , mirpo jo sipas standardit të formularit të miratuar prn KRPP-se e që është obligative për të gjithë OE të cilët shprehin interesim për të aplikuar , poashtu në marveshjen e ofruar nga GOE i rekomanduar pran AK-se në anën tjetër caktohet lideri i HART Engineering Sh.p.k, ndërsa mrenda marveshjes tek pika 03 Veprimtarite dhe përgjegjësit tek pika A thuhet citoj “ ***përgjegjësia i bije kompanis se dyte sipas marveshjes interne qe kane ne mes vete***”...., e që për Panelin Shqyrtues kjo marveshje nuk mund të pranohet ngase shtrohet pyetja se cilat janë përgjegjësit e liderit në këtë raste, ku i gjithë projekti sipas marveshjes i atribohet parnerit konzercium , kështu duke mos ofruar asnje përgjegjësi lideri në implementimin e kontratës , dhe përshkrimi i till i kësaj marveshje nënkupton si lloj nën-kontraktimi .

Lidhur me pretendimet ankimor 2 dhe 4 mbështet konstatimet. Ndërsa pretendimin 3 nuk e mbështet ku thuhet se autorizimi nuk është dorëzuar me titull te kontrates dhe nr të prokurimit , PSH ka analizuar kerkesen e parashtruar ne NJK dhe DT dhe konstaton se kerkesa e paraqitur nga AK ja eshte OE duhet te dorezoj Autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar) per pozicionet 2.2, 4.1, 5.1, 5.2, 5.4, 6.1, 7.2, 9.4 *Deshmi dokumentare* : 6. Autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar), andaj PSH nuk e mbështet konstatimin e ekspertit ku thot citoj “ *Mungesa e këtyre të dhënave esenciale e bën autorizimin të paplotë dhe të papërshtatshëm në raport me kërkesat e parashikuara nga autoriteti*

kontraktues. Këto mangësi përbëjnë devijim substancial nga dokumentacioni i tenderit dhe pamundësojnë verifikimin e kapacitetit teknik të ofertuesit fitues...'', ngase një OE nuk mund të eliminohet derisa AK nuk ka paraqitur kërkesë që autorizimet duhet të jene ne emër te projektit e as me nr te prokurimit.

Rrjedhimishtë, Paneli Shqyrtues mbështetur në nenin 1 dhe 7 të LPP-së ka vendoru ta anuloj B58 Njoftim mbi vendimin e AK-se , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Ndertimi i tribunes lindore te stadiumi 2 Korriku - faza e III-te me numër të prokurimit 616-25-7285-5-2-1, ndërkaq lënda kthehet në Rivlersim, duke kërkuar nga AK që gjatë Rivlersimit ti përmbahet në tërsi dispozitave ligjore të LPP-se, dhe kërkesave të parashtruar në NJK dhe DT.

-Përfundim -

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: